



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7036/2025

A.nr.1489/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshin, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1489/2025, të datës 28.07.2025, të parashtruar nga ankuesja G.B, nga Gjilani, kundër organit të punësimit: Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 28.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.1489/2025, e datës 28.07.2025, e parashtruar nga ankuesja G.B, ashtu që, ***anulohet*** Njoftimi me numër protokolli 02-016-56374, i datës 08.07.2025 përkatësisht lista përfundimtare e kandidatit fitues dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe vlerësimit profesional lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017761 për pozitën Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik, ***ndërsa, procedura e pranimi kthehet në fazën e verifikimit paraprak***, poashtu obligohet Zyrtari Kryesor Administrativë-Kryetari i Komunës që të ndërmerr veprimet ashtu që komisioni i pranimi të jetë konformë legjislacionit përkatës të zyrtarëve publik.

II. Obligohet Zyrtari Kryesor Administrativë-Kryetari i Komunës dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, siç përcaktohet në pikën I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, G.B (*tutje referuar: Ankuesja*), me datë 28.07.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me konkursin me Nr. Reference RN00017761, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik” i shpallur nga Komuna e Gjilanit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.08.2025, 08.09.2025 dhe 23.09.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit, ndërsa kjo e fundit më datë 03.10.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, me datë 09.09.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:6048/2025, përmes të cilit ankesës së ankuses nën shenjë A.nr.1489/2025 të datës 28.07.2025 ia ka vazhduara afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova.: Ankesën me numër protokolli 5103/2025 të datës 28.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuses; Vërtetimin e datës 11.12.2024; Raportin e punës 2023; Njoftimin për kandidatin fitues datës 08.07.2025; Konkursin me Nr.Reference RN00017761, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik; Listën e kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim datës 04.07.2025; Raportin e punës për vitin 2024; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.08.2025, 08.09.2025 dhe 23.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 03.10.2025; Shkresën e datës 09.01.2025 për aprovimin dhe konfirmimin e Qëndrueshmërisë Buxhetore; Vendimin me numër protokolli 02/874 të datës 26.06.2025 për formimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Listën nga SIMBNJ për vlerësim të intervistës me gojë; Aplikacionin e ankuses i datës 05.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-18; Aplikacionin e kandidates fituese i datës 28.05.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-14; Vendimin me numër protokolli 6048/2025 të datës 09.09.2025 për vazhdimin e afatit për vendosje të ankesës së ankuses.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, dhe ka konstatuar se ankesa e ankuses **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rrjedhë se Komuna e Gjilanit më datën 02.05.2025 ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN00017761, me emrin Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”, në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, klasa profesional 2, me afat aplikimi nga data 03.05.2025 deri më datë 01.06.2025.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 45 kandidatë, ndërsa fazën e verifikimit paraprak e kanë kaluar 30 kandidatë në mesin e tyre edhe ankuesja. Sipas njoftimit të datës 04.07.2025 testin me shkrim e ka kaluar vetëm një kandidatë.

Pas përfundimit të procedurës, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit, më datë 08.07.2025, ka publikuar njoftimin me numër protokolli 02-016-56374 për rezultatet përfundimtare, me kandidaten fituese B.A me 90.6 pikë.

Ankuesja, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se ka shkelje të procedurave të konkursit, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dyshimeve për mungesë transparence ,barazie dhe integriteti në procesin e përzgjedhjes, si dhe hedhë dyshime se kandidatja fituese nuk ka përvojë pune në fushën relevante, kërkon që të shqyrtohet tërësisht procedura sipas këtij konkursi mbi bazë të parregullsive ligjore dhe procedurale, të pezullohet vendimi për emërimin e kandidatit fitues dhe të rihapet procesi i vlerësimit të kandidatëve që kanë përvojë dhe kualifikime të dëshmuara përmes një komisioni të ri dhe të pavarur.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00017761 për Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka konstatuar se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë: **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), Juridike, Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale, Gjeografi, Administratë Publike. **Kërkesat Specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacion në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Rrjedhimisht, Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuses, ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 9 paragrafi 1, ku përcaktohet se: *1. Kriteret e përgjithshme që një person duhet t'i plotësojë në procedurën e rekrutimit, për t'u pranuar si zyrtar publik në cilëndo kategori apo nivel, janë: 1.1. të jetë shtetasi Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi; 1.3. të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik; 1.7. të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe 1.8. të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj*”, si dhe nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *2.Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.*

Nëse i referohemi pikës 5 të konkursit tek dokumentet që duhet dorëzohen si pjesë e aplikimit kërkohet: *Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës; Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës, Nëse diploma është e fituar jashtë vendimit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmo se diploma e fituar është ne procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Përvoja e punës e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtetet tjetër dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës; Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit; Kopjen e dokumenteve tjetra që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit dhe të deklarata në aplikacion.*

Bazuar në kuadrin përkatës ligjor, si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses, respektivisht ka shqyrtuar aplikacionin e kandidates fituese të datës 28.05.2025, e sipas të cilës rezulton se e njëjta posedon Diplomën me Nr. 13550 të datës 15.07.2024 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datës 26.03.2013 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik duke marr titullin Ekonomiks BSC, ndërsa lidhur me përvojën e punës sipas Vërtetimit për Praktikën e kryer të lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme me datës 16.02.2012 ka kryer praktikën para diplomimit në këtë institucion prej datës 16.01.2012 deri më datë 16.02.2012, sipas Vërtetimit të datës 26.07.2024 të lëshuar nga Danushi Com Sh.p.k e njëjta ka qenë në marrëdhënie punë nga data 01.04.2021 deri më datë 31.05.2024, sipas aneks kontratës për punë dhe detyra specifike Nr.01-696/19, të datës 01.02.2019 të lëshuar nga kompania publike VALA e njëjta nga data 01.06.2019 deri më datë 28.09.2019 ka punuar si Zyrtar i Shitjes, sipas Rekomandimit nga kompania ALBIMI LTD të datës 15.07.2024 e njëjta nga data 15.08.2015 e deri më datë 31.01.2019 ka qenë Menaxhere e Shitjes, sipas Referencës së datës 31.07.2024 të lëshuar nga kompania N.T.P “Thes -Ari” e njëjta nga prilli 2013 deri në fillim të gushtit 2014 ka qenë e punësuar në këtë kompani. Kolegji vëren se sipas aplikacionit të kandidates fituese të dërguar nga Komuna e Gjilanit, rezulton se e njëjta përvojën e punës sipas vërtetimeve/rekomandimeve apo referencave nuk e ka të mbështetur edhe më dëshmi nga pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave e obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, standard ky i vendosur sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit e Kosovës, e cila ka theksuar se dëshmitë e përvojës së punës duhet të dëshmohen me kontratë pune dhe me vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe dëshmi të lëshuar nga Trusti Pensional i Kosovës, detyrim ky ligjor i përcaktuar me nenin 9 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale” dhe standardeve të vendosura nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, andaj nisur nga konstatimet si më sipër Kolegji i Këshillit, konstaton se kjo kandidate nuk ka plotësuar kërkesat e përgjithshme formale të konkursit ndërlidhur me përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit, konstaton se më datë 26.06.2025 Kryetari i Komunës së Gjilanit ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 02/874 për formimin e Komisionit të pranimit në këtë përbërje: B. K-kryesues, M.

Z. L, H.K, D.K M dhe I.L të gjithë anëtar e për të cilët janë caktuar edhe anëtarët zëvendësues, e për rrjedhojë Kolegji i Këshillit, ka marr si prova materiale edhe akt emërimet e anëtarëve të këtij komisioni dhe ka konstatuar se kryesuesi i komisionit B. K mban pozitën Menaxher i Burimeve Njerëzore, anëtarët M. Z. L sipas Vendimit të datës 10.03.2025 është caktuar ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Sektorit për Buxhet dhe Financa në Drejtorinë e Arsimit, H. K sipas akt emërimit mban pozitën Udhëheqës - Shtëpia e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuar për të Rritur-Dardanë, D.K M mban pozitën Zyrtare për Buxhet dhe Financa dhe I. L mban pozitën Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financa. Mbi këto prova duke marr parasysh se anëtari i Komisionit të Pranimit, z. H. K i cili sipas akt emërimit të datës 14.04.2015 mban pozitën Udhëheqës-Shtëpia e Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuar për të Rritur-Dardanë, Kolegji i Këshillit, konstaton, se sipas nenit 5 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *“1. Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit, sipas paragrafit 2 të këtij neni është përcaktuar: 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë, kurse sipas paragrafit 3 të këtij neni përcaktohet: 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës”*. Në referim të çështjes dhe dispozitave të cekura më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se të punësuarit në kuadër të Shtëpisë së Komunitetit për Personat me Aftësi të Kufizuar për të Rritur, nuk hyjnë në kuadër të pozitave të shërbimit civil por hyjnë në kuadër të pozitave të nëpunësit të shërbimit publikë, sepse kryejnë shërbime të drejtpërdrejta publike. Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vë në dukje se Komisioni i Pranimit duhet të jetë i themeluar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: *2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, në këtë rast në kuadër të komisionit të pranimit për këtë pozitë nuk kemi tre nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit.*

Andaj, bazuar si më sipër, Kolegji i Këshillit me qëllim të vendosjes së ligjshmërisë, vendosi që të aprovoj si të bazuar ankesën e ankueses të anuloj Njoftimin me numër protokolli 02-016-56374, të datës 08.07.2025 për rezultatet përfundimtare dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e verifikimit paraprak dhe vlerësimit profesional lidhur me konkursin me Nr. Reference: RN00017761 për pozitën Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik, ndërsa, procedurat e pranimit kthehen në fazën e verifikimit paraprak, ndërsa obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Gjilanit, që procedurën e pranimit sipas konkursit me Nr. Reference: RN00017761, me emrin e Grupi i Shkencave Shoqërore, gjegjësisht për pozitën e punës “Zyrtar për Zhvillim Socio Ekonomik”, ta vazhdoj nga faza e verifikimit paraprak, gjithashtu duke e obliguar edhe Zyrtarin Kryesor Administrativë-Kryetarin e Komunës që edhe komisioni i pranimit të ndryshohet konformë arsyetimit të dhënë si më lartë, ashtu që Komisioni i Pranimit duhet të jetë i themeluar sipas kërkesave ligjore të përcaktuara me nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1489/2025, datë 28/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses G.B;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.